



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë __/__/2021

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.119, DATË 14.09.2014,
“PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr.119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën a) të pikës 1, të nenit 2, togfjalëshi “organ administrativ” zëvendësohet me togfjalëshin “organ publik” si dhe pas togfjalëshit “...të prokurorisë së çdo niveli...” shtohet togfjalëshi “...për aq sa ushtrojnë funksione administrative...”
2. Në pikën 6 të nenit 2, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
Fjalët “nëpunës civil” zëvendësohen me fjalët “nëpunës i autoritetit publik”.
3. Pas pikës 6, të nenit 2, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. “Komisioneri” nënkupton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që është autoriteti i pavarur përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Ligji, që ka për qëllim të mbrojë të drejtën për informim, si e drejtë dhe liri themelore e njeriut.”

Neni 2

Pas pikës 4 të nenit 3, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. E drejta për informim sipas këtij ligji, garantohet në përputhje me rregullimet ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.”

Neni 3

Pas nenit 3, shtohet neni 3/1 me këtë përmbajtje:

Neni 3/1

Kompetencat e Komisionerit në fushën e të Drejtës për Informim

1. Në fushën e së drejtës për informim, Komisioneri ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) shqyrton ankesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në këtë ligj;
 - b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;
 - c) kryen hetimet e nevojshme administrative kryesisht ose me ankesë gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;
 - ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) ka të drejtën t'i kërkojë, me një vendim të arsyetuar, autoriteteve kompetente të fillojnë një procedurë deklasifikimi sipas vlerësimeve rast pas rasti;
 - dh) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - e) nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit, përfshirë edhe mbështetjen me trajnime;
 - ë) monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit;
 - f) kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;
 - g) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;
 - gj) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashtron mendim me shkrim për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit;
 - h) vënie në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë;
 - i) kryen trajnime të nevojshme dhe të vazhdueshme të koordinatorëve për të drejtën e informimit, të punonjësve të administratës publike si dhe grupeve të interesit.
 - j) propozon organit publik marrjen e masave disiplinore ndaj personit/personave përgjegjës, kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji.
2. Vendimet e Komisionerit janë të hapura për publikun dhe shpallen në faqen e internetit të institucionit.

3. Në rastet kur është e nevojshme, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, Komisioneri mund të delegojë kompetenca të dhëna në këtë ligj tek struktura përgjegjëse për të drejtën e informimit.
4. Komisioneri, në ushtrimin e kompetencave të veta, mbështetet nga një Bord Këshillimor.
5. Bordi Këshillimor drejtohet nga Komisioneri dhe ka në përbërje të tij:
 - a) 2 anëtar nga fusha akademike;
 - b) 1 anëtar nga institucionet qendrore;
 - c) 1 anëtar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
 - c) 2 anëtar nga organizatat e shoqërisë civile.
6. Struktura përgjegjëse e të drejtës për informim pranë Komisionerit shërben si sekretariat i Bordit Këshillimor.
7. Mënyra e përzgjedhjes, funksionimit dhe shpërbllimit të Bordit Këshillimor dhe sekretariatit përcaktohen në rregulloren e tij e cila miratohet nga Komisioneri. Bordi Këshillimor mblidhet me kërkesë të Komisionerit, por në çdo rast jo më pak se një herë në çdo tre muaj.
8. Komisioneri, në ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave sipas këtij ligji, nxjerr urdhra, udhëzime, rekomandime dhe akte të tjera administrative me karakter të përgjithshëm, të cilat botohen në Fletoren Zyrtare.

Neni 4

Pas pikës 2, të nenit 4, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Me qëllim publikimin e programit të transparencës, çdo autoritet publik duhet të ketë faqen e tij në internet.”

Neni 5

Në nenin 7, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën c) të pikës 1, të nenit 7 togfjalëshi “të vendimit përkatës” zëvendësohet me togfjalëshin “ndaj veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike”.
2. Në shkronjën ë) të pikës 1, të nenit 7 togfjalëshi “...të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik” zëvendësohet me togfjalëshin “...legjislacionit për prokurimin publik.” dhe togfjalëshi “...të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” zëvendësohet me togfjalëshin “...legjislacionit për koncesionet dhe partneritetin publik privat”
3. Pas shkronjës l) të pikës 1, të nenit 7 shtohet shkronja ll) me këtë përmbajtje:

“ ll) bëhen publik në programin e transparencës vendimet e pranimit të kërkesës për fillimin e procedimit penal, të mospranimit apo refuzimit të procedimit penal, si dhe vendimet e depozitimit të çështjes në gjykatë nga ana e organeve të prokurorisë, për veprat penale që kanë interes të lartë publik, sipas përcaktimeve në programin model të transparencës”.

4. Pas pikës 3, të nenit 7 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Informacioni që bëhet publik pa kërkesë nëpërmjet programit të transparencës përditësohet çdo herë që pëson ndryshime dhe tregon datën e përditësimit të fundit.”

Neni 6

Në pikën 1, të nenit 8, fjalia e dytë ndryshohet si vijon:

“Ky regjister përditësohet çdo herë që paraqitet një kërkesë dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik”.

Neni 7

Në nenin 10, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 1, e nenit 10, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Autoriteti publik ka detyrimin e njoftimit të menjëhershëm të emërimit apo ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Komisionerit.”

2. Pas pikës 2, të nenit 10, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Nëpunësi i caktuar koordinator, nuk mund të jetë objekt i procedimit disiplinor për detyrat e parashikuara në këtë ligj, pa miratimin e Komisionerit. Koordinatori për të drejtën e informimit për sa kohë ushtron këtë detyrë, për natyrë të veçantë pune përfiton një shtesë mbi pagën mujore, e cila përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Pika 5, e nenit 15, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të përkohshëm.”

Neni 9

Në nenin 17, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1, të nenit 17, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Para dhënies së këtij informacioni, autoriteti publik njofton mbajtësin e këtyre të drejtave”.

2. Pika 7, e nenit 17, ndryshohet si vijon:

“Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të përkohshëm”.

Neni 10

Në nenin 18, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën a) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “50 000 deri në 150 000”.
2. Në shkronjën c) të pikës 2, të nenit 18, fjalët “...në pikën 1, të nenit 5” zëvendësohet me fjalët “në nenin 5”.
3. Pas shkronjës ç) të pikës 2, të nenit 18, shtohet shkronja ç/1 me këtë përmbajtje:
“ç/1 mos përditësimi i programit institucional të transparencës, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 7, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;”
4. Në shkronjën d) të pikës 2, të nenit 18, shifra “50 000” zëvendësohet me shifrën “25 000”.
5. Në shkronjën dh) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “50 000 deri në 150 000”.
6. Në shkronjën e) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “50 000 deri në 150 000”.
7. Në shkronjën ë) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “50 000 deri në 100 000”.
8. Në shkronjën f) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “50 000 deri në 150 000”.
9. Në shkronjën j) të pikës 2, të nenit 18, shifrat “150 000 deri në 300 000” zëvendësohen me shifrat “25 000 deri në 50 000”.
10. Shkronja ll) e pikës 2, të nenit 18, ndryshohet si më poshtë vijon:
“ll) mos zbardhja e dokumenteve zyrtare, fshehja, çdo veprim apo mosveprim në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.”
11. Pas shkronjës ll) të pikës 2, të nenit 18, shtohen shkronjat m), n) dhe nj) me këtë përmbajtje:

“m) mos njoftimi i kërkuesit për procedurën e rishikimit, mos arsyetimi i vendimit, ose mos njoftimi i Komisionerit për fillimin e kësaj procedure dhe vendimit përfundimtar të autoritetit publik, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 17 të këtij ligji, dënohen secila me gjobë 50 000 deri në 150 000 lekë.

- n) mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik në përputhje me parashikimet e këtij ligji, ose mos njoftimi pranë Komisionerit mbi këtë caktim, sipas dispozitave të pikës 1, neni 10 dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.
- nj) mos bashkëpunimi i autoritetit publik me Komisionerin sipas nenit 24/1 të këtij ligj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë.”

Neni 11

Në nenin 19, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, të nenit 19 pas shkronjës “ç”, shtohet shkronja “ç/1” dhe pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “gj”, “l”, “ll”, “m”, “n” dhe “nj”.
2. Pika 2, e nenit 19 ndryshohet si më poshtë vijon:
“2. Në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi që rregullon procedurën administrative, titullari i autoritetit publik mund të delegojë kompetencën e tij për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikën 4 të nenit 7, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, te nëpunësi më i lartë i autoritetit publik. Në këtë rast, nëpunësi të cilit i është deleguar kompetenca, mban përgjegjësi ligjore për shkeljet administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”
3. Pas pikës 2, të nenit 19, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:
“Për institucionin e Presidencës, Kuvendit, Kryeministrisë, ministritë, si dhe institucionet e pavarura, titullar i autoritetit publik konsiderohet Sekretari i Përgjithshëm.
4. Në pikën 3, të nenit 19 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Në rastet kur përgjegjësia për mos përmbushjen e kërkesave të parashikuara në këtë pikë nuk bie mbi koordinatorin e të drejtës për informim, përgjegjësia administrative zhvendoset tek punonjësi përgjegjës, i cili me veprimet apo mosveprimet e tij, ka shkelur dispozitat e këtij ligji.”
5. Pas pikës 4, të nenit 19 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
“5. Në rast pamundësie të identifikimit të personit përgjegjës sipas parashikimeve në pikat 1, 3 dhe 4, të këtij neni, përgjegjësia administrative zhvendoset tek autoriteti publik.”

Neni 12

Në pikën 3, të nenit 21, pas shkronjës “ll” shtohet dhe shkronja “nj”.

Neni 13

Në nenin 24, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Fjalia e fundit e pikës 3 të nenit 24, ndryshohet si vijon:

“Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri kryen inspektim pranë autoritetit publik dhe/ose zhvillon seancë dëgjimore publike, me pjesëmarrjen e palëve.”

2. Në shkronjën a) të pikës 5, të nenit 24, shtohet pika iv) me këtë përmbajtje:
“ iv) nuk kanë kaluar afatet e parashikuar në nenin 15 të këtij ligji”.
3. Në shkronjën b) të pikës 5, të nenit 24 shtohet togfjalëshi “...përfshirë sipas rastit, propozimin për të deklasifikuar informacion.”
4. Pas shkronjës ç) të pikës 5, të nenit 24 shtohet shkronja d) me këtë përmbajtje:
“d) vendos për marrjen e masave strukturore të përshtatshme nga ana e autoritetit publik për rastet kur shkeljet janë të përsëritura”.
5. Pas pikës 6 të nenit 24, shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:
“6/1. Vendimi i Komisionerit bëhet titull ekzekutiv me kalimin e afatit të përcaktuar për ekzekutimin e tij dhe vihet në ekzekutim nga kërkuesi në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile”

Neni 14

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

Neni 24/1

Detyrimi për bashkëpunim

1. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.
2. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 15 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.
3. Autoritetet publike informojnë publikun në faqen e tyre të internetit mbi Komisionerin dhe kompetencat e tij dhe publikojnë në faqen e tyre të internetit vegëzën lidhëse me faqen e internetit të Komisionerit.

Neni 15

Pas nenit 24/1 shtohet neni 24/2 me këtë përmbajtje:

Neni 24/2

Kërkesat dhe ankesat e pabazuara

Kur kërkesat ose ankesat janë qartazi të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, Autoriteti Publik ose Komisioneri, sipas rastit, mund të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me kërkesën ose ankesën. Autoriteti Publik

ose Komisioneri, sipas rastit, mban barrën e provës lidhur me pabazueshmërinë dhe natyrën e tepruar të kërkesës ose ankesës.

Vendimi i Komisionerit është i ankimeshëm në gjykatën administrative brenda 30 ditëve nga marrja dijani.

Neni 16

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

Neni 26/1
Ndërgjegjësimi dhe edukimi

Zyra e Komisionerit kryen veprimtari ndërgjegjësuere dhe trajnuere me autoritetet publike dhe grupet e interesit.

E drejta për informim është pjesë e kurikulës së arsimit parauniversitar dhe të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Neni 17

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

Neni 27/1
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të aktit nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 10 të ligjit.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I